



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 15 AKTI

NR. 51 VENDIMI

Tiranë, më 30.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)

Kryesuese

Pamela Qirko

Anëtare

Suela Zhegu

Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në Tiranë, më datë 26.07.2018, ora 10:00, në Pallatin e Kongreseve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Bledar Novruz Abdullahi, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, i përfaqësuar nga avokati Artan Hajdari, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, i cili kërkoj konfirmimin në detyrë të z. Bledar Abdullahi.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5, dhe nenet Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Z. Bledar Abdullahi, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur, më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Në mbledhjen e trupit gjykues, të datës 14.12.2017, u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues znj. Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. John Leonardo.

4. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (referuar si “Komisioni”) janë administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillimin e hetimit administrativ.

6. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

1. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
2. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
3. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
4. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

7. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi”.

8. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (IKLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

9. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, e ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

10. Trupi gjykues, në prani dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga analiza e çështjes në tërësi, ka konkluduar se:

10.1 Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit u konstatua:

- ➔ Deklarim i pasaktë dhe i pamjaftueshëm në përputhje me ligjin;
- ➔ Mosdeklarim i burimit të krijimit për pasuritë;
- ➔ Mungesë e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e paluajtshme.

¹ Raporti nga ILDKPKI-ja i dërguar me shkresën, nr. *** prot., datë 09.11.2017, i përbërë nga 13 faqe.

² Me shkresën, nr. *** prot., datë 15.11.2017, dërgohet raporti i DSIK-së.

³ Me shkresën, nr. *** prot., datë 15.01.2018, dërgohet raporti i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

10.2 Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

10.3 Nga vlerësimi në tërësi i raportit për vlerësimin e aftësive profesionale, të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, u konstatuan problematika apo cilësi që cenojnë anën profesionale të gjyqtarit, që kanë të bëjnë me:

- Shkelje të afateve në gjykimin e çështjeve;
- Zvarritje dhe mosrespektim formal të ligjit, ku subjektit i është tërhequr **“vëmendja me shkrim”**⁴, për shkak të gjykimit tej afatit standard, të parashikuar për këtë lloj çështje civile.

11. Trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 06.07.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikën 5 të nenit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

12. Për një proces të rregullt ligjor, z. Bledar Abdullahi, i janë garantuar të drejtat, si: për t’u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; për përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, më datë 6 korrik 2018, duke i kaluar barrën e provës. Për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit, subjektit iu dhanë 5 ditë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

13. Z. Bledar Abdullahi u njoh me rezultatet e hetimit dhe ka paraqitur shpjegimet e tij më datë 18.07.2018, si dhe ka paraqitur një kërkesë për të thirrur dëshmitarë. Nga ana e Komisionit, kjo kërkesë u mor në shqyrtim dhe u rrëzua me vendimin e datës 23.07.2018, me arsyetimin se fakti që kërkon të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen dhe ka për qëllim zvarritjen e gjykimit. Subjekti u njoftua për këtë vendim dhe disponon kopje të tij. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se nuk është dakord me analizën financiare dhe konstatimet e Komisionit nga hetimi i kryer.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

14. Sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Bledar Abdullahi ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, por në shpjegimet e tij ka reflektuar një

⁴ Sipas raportit të KLD-së, cituar më sipër.

qëndrim emocional, me shpjegime të përsëritura dhe kontradiktore, të paqarta, jo koncize, sjellje e cila është mbajtur në konsideratë në procesin e vendimmarrjes.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

15. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

15.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

15.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

15.3 Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

15.4 Komisioni, referuar Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017, dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

15.5 Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga ana e subjektit në ILDKPKI; ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja (dh) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (e) shpjegimet me

shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15.6 Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, me funksion gjyqtar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfshiu: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

16. Subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, është bërë subjekt deklarues në vitin 2003, me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private nga viti 2003-2016 si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (Deklarata-Vetting).

17. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësisë për fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo konflikt interesi.

17.1 Me qëllim vlerësimin sa më të saktë dhe korrekt të pasurisë së subjektit, Komisioni analizoi dokumentacionin përkatës, që përbëhet nga:

- Deklarata e pasurisë - Shtojca 2;
- Deklaratat e pasurisë të paraqitura ndër vite;
- Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- Provat e depozituara nga vetë subjekti, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
- Informacionet dhe të dhënat e administruara nga ky Komision nëpërmjet organeve shtetërore, personave fizikë dhe juridikë;
- Shpjegimet dhe deklaratat e subjektit të rivlerësimit në përgjigje, të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, të rezultateve të hetimit administrativ dhe shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore.

18. Pasaktësi në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”:

18.1 Komisioni, nga verifikimi i “Deklaratës së Pasurisë - Shtojca 2” ka evidentuar faktin se personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit, sipas certifikatës familjare (nëna, babai dhe vëllai),

nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor për deklarim në përputhje me ligjin nr. 9049/2003, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 84/2016.

Komisioni, lidhur me këtë pasaktësi ka kërkuar interpretim ligjor pranë ILDKPKI-së. Me shkresën nr. *** prot., datë 19.03.2018, ILDKPKI-ja ka arritur në përfundimin se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur (nëna, babai dhe vëllai) me subjektin e rivlerësimit, nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor për deklarim, pasi nuk kanë plotësuar dhe nuk kanë dorëzuar pranë ILDKPKI-së, autorizimin dhe formularin e pasurisë së personave të lidhur, në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”.*

Në këto kushte, ILDKPKI-ja, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përfundimisht se:

a) Deklarimi i subjektit nuk është i saktë në përputhje me ligjin.

Në lidhje me këtë konstatim, pas kalimit të barrës së provës, në shpjegimet përfundimtare të datës 18.07.2018⁵, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar shprehimisht se: *“Mosdeklarimi i personave të lidhur sipas certifikatës familjare, në kushtet: 1. Kur ka ardhur si pasojë e mospërmbushjes së detyrimit ligjor nga ana e institucionit (jo për fajin tim), dhe se ndërkohë; 2. Dokumentacioni ekziston, pasi është depozituar në një institucion legjitim, sikundër është Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (faktuar me shkresën, nr. *** prot., datë 16.01.2017); 3. Institucioni i ILDKPKI-së nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për njoftim plotësim dokumentacioni, referuar nenit 24 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, me ligjin nr. 45/2014; 4. Në rastin konkret bëhet fjalë jo për persona në ngarkim”.*

Subjekti i rivlerësimit pretendon se: *“Rrethanat e mësipërme nuk janë provë e mjaftueshme për ta konsideruar deklarimin e subjektit si jo të saktë dhe në përputhje me ligjin apo deklarim të pamjaftueshëm në këndvështrim të pikës 3 të nenit 61, apo dhe të pikës 5 të po këtij neni të ligjit nr. 84/2016”.*

Arsyetimi ligjor

Pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pa mbështetura në ligj, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor, bazuar në nenin D, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 31/1 të ligjit nr. 84/2016, të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2, dhe ta dorëzojë pranë ILDKPKI-së. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë të dhënat e detyrueshme për deklarim, pjesë përbërëse e këtij procesi deklarimi, me përshkrimet e kërkuara sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.

Persona të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, janë rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person i përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes

⁵ Për më tepër referoju dosjes se subjektit, shpjegimet e datës 18.07.2018.

civile, për subjektin e rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit. Deklarimi përfshin pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit/personave të lidhur përfshirë interesat privatë që i ka në pronësi, posedim ose në përdorim, në përputhje me ligjin. Kur pasuria e personave të lidhur (bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore, persona të tjerë sipas certifikatës familjare dhe bashkëjetuesi/ja) është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas dhe i bashkëlidhet deklaratës së subjektit të rivlerësimit.

→ Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor për deklarim, në bazë të ligjit nr. 84/2016, në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”, personat e përmendur në certifikatën familjare duhet të deklaronin saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre.

18.2 Nga hetimi i kryer Komisioni ka konstatuar se personat e lidhur, konkretisht prindërit e z. Bledar Abdullahi, janë investitorë në fondin e pensioneve “Raiffeisen Prestige”, investime të padeklaruara në Deklaratën-Vetting.

Me shkresën, nr. *** prot., datë 05.01.2018, “Raiffeisen Invest” ka konfirmuar se:

“Babai i z. Bledar Abdullahi është investitor në fondin “Raiffeisen Prestige”, që prej datës 10.04.2013 dhe gjendja në datën 31.12.2017, është në shumën prej 2.003.906,06 lekësh.

Nëna e z. Bledar Abdullahi, është investitore në fondin “Raiffeisen Prestige”, që prej datës 22.05.2013 dhe gjendja në datën 31.12.2017, është në shumën prej 943.291,85 lekësh.”.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, i cili në shpjegimet e datës 18.07.2018, ka argumentuar shprehimisht se: *“Fshehja e pasurisë së personave të lidhur nuk mund të qëndrojë si konstatim, kur gjatë gjithë kohës së hetimit administrativ rezulton e provuar se subjekti i ka bërë me dije Komisionit që deklaratat e pasurive për personat e lidhur të përmendur në certifikatën familjare i ka depozituar pranë Kuvendit të Shqipërisë, më datë 16.01.2017, si rezultat i procesit të konkurrimit për anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Nuk mund të mbajë përgjegjësi subjekti për veprimet apo mosveprimet e organeve publike që nuk kryejnë funksionin e tyre. Kuvendi, si organ i ngarkuar nga ligji për mbledhjen e dokumentacionit të kandidatëve që konkurronin për Këshillit të Lartë Gjyqësor, duhet të dërgonte të gjithë dosjen e subjektit tek institucionet e vlerësimit, në kushtet që kur u hap konkurrimi këto institucione nuk ishin krijuar ende. Megjithatë, Komisioni i kishte të gjitha mundësitë për të kërkuar informacion nga Kuvendi lidhur me saktësinë/vërtetësinë e deklarimeve të dhëna nga subjekti. Por, siç rezulton në rastin konkret, Komisioni ka refuzuar të hetojë mbi këto fakte, duke arritur në përfundimin tërësisht të gabuar në cilësimin si “fshehje të pasurisë”, kur sjellja e subjektit gjatë gjithë hetimit administrativ në asnjë moment nuk ka rezultuar të kishte si qëllim kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve për të fshehur pasuritë, por, përkundrazi, subjekti në të gjitha shpjegimet e dërguara me e-mail ka sqaruar lidhur me deklaratat e pasurisë, ku i ka dorëzuar, ku ndodhen, duke shprehur disponibilitetin e tij për t’ia vënë në dispozicion Komisionit”.*(sipas shpjegimeve të z. Abdullahi).

Lidhur me burimin e krijimit për investimet në fondin “Raiffeisen Prestige”, në emër të prindërve, subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion dhe dokumentacion, nëpërmjet komunikimit elektronik, me *e-mail-in* e datës 22.03.2018.

Subjekti i rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 30.03.2018, ka shpjeguar ndër të tjera shprehimisht se: *“Për sa i përket burimit të krijimit nga ana e prindërve, më bëhet me dije se ato janë të ardhura të përfituara nga paga, pensionet, ekonomia ndihmëse në fshat dhe kursime ndër vite, fakt ky i reklamuar prej tyre pranë autoriteteve bankare dhe në momentin e depozitimit (hapjes së fondit).*

Konkretisht, babai im N.A., rezulton se, sipas vërtetimit mbi “Pasqyrën e llogarisë”, datë 20.01.2017, ka llogari bankare në “Fondin e Investimeve”, në shumën prej 2,020,309.06 (dy milionë e njëzet mijë e treqind e nëntë pikë, zero gjashtë) lekësh. Lidhur me burimin e krijimit, babai im, shtetasi N.A., deklaroi se ato janë të ardhura nga paga, pensioni dhe ekonomia ndihmëse në fshat, fakte këto për të cilat vihet në dispozicion dokumenti, vërtetim lëshuar nga Drejtoria Rajonale Arsimore Berat, në përmbajtje të së cilit vërehet se babai im ka përfituar nga paga si mësues për periudhën 01.01.1998 - 31.01.2012, shumën prej 3,258,474 (tre milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh; si dhe vërtetimi lëshuar nga DRSSH-së Tiranë, në përmbajtje të së cilit rezulton se për periudhën 01.05.2012 - 31.01.2017, të ardhurat nga pensioni janë në shumën prej 1,303,871 (një milion e treqind e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një) lekësh.

Ndërkohë, nëna ime A.A. rezulton se, sipas vërtetimit mbi “Pasqyrën e llogarisë”, datë 22.01.2017, ka llogari bankare në “Fondin e Investimeve” shumën prej 909,343.52 (nëntëqind e nëntë mijë e treqind e dyzet e tre, pikë pesëdhjetë e dy) lekësh. Lidhur me burimin e krijimit, nëna ime, shtetasja A.A., deklaroi se ato janë të ardhura nga paga, pensioni dhe ekonomia ndihmëse në fshat. Fakte këto për të cilat vihet në dispozicion vërtetimi i lëshuar nga Qendra Shëndetësore Kutalli, Berat në përmbajtje të së cilit vërehet se nëna ime ka përfituar nga paga si ndihmësmjete, ndihmësmami dhe kryeinfermiere për periudhën janar 1998 - dhjetor 2012, në shumën prej 3,002,903 l (tre milion e dy mijë e nëntëqind e dy) lekësh; si vërtetim lëshuar nga DRSSH-së Tiranë, në përmbajtje të së cilit rezulton se për periudhën 01.05.2012 - 31.01.2017, të ardhurat nga pensioni janë në shumën prej 1,230,388 (një milion e dyqind e tridhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë) lekësh.

Rrjedhojë e sa më sipër, si burim të ardhurash, edhe pse nuk mund të reklamoheshin ligjërisht është edhe fakti se familja ime e trungut përfiton të ardhura dhe nga ekonomia ndihmëse si familje bujqësore (disponon tokë arë të përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Mbi tokën” dhe mbi 100 (një qind) rrënjë ullinj në prodhim të vazhdueshëm)”.

Komisioni, nga verifikimi i llogarive bankare në “Raiffeisen Bank” të personave të lidhur, përkatësisht të prindërve, ka konstatuar se ata kanë pasur llogari depozitash që në vitin 2008. Babai N. A. ka pasur llogari depozitash në “Raiffeisen Bank”, që nga viti 2008, të cilat janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

Nëna A. A. rezulton se ka pasur llogari depozitash në “Raiffeisen Bank” që nga viti 2010, të cilat janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

Arsyetimi ligjor

Shpjegimi i dhënë nga subjekti, se ai ka depozituar deklaratat e personave të lidhur pranë Kuvendit të Shqipërisë nuk qëndron, pasi subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor për të plotësuar “Deklaratën e Pasurisë”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij ligji dhe për ta dërguar pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 31 të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni, nisur nga fakti që personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk kanë deklaruar investimet e tyre në “Fondin Raiffeisen Prestige”, në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”, ka konkluduar gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e personave të lidhur, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, detyrim që kanë subjektet e rivlerësimit për të përmbushur pranë organit të ILDKPKI-së.

→ Komisioni ka konstatuar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i pasaktë dhe i pamjaftueshëm sipas ligjit.

18.3 Komisioni, nga hetimi i kryer në deklaratimet periodike për vitet 2014, 2015, ka evidentuar faktin se bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit ka plotësuar vetëm faqen 8 të formularit të deklaratimit, “Autorizimin”, duke evidentuar faktin që disponon pasuri veçmas, por nuk ka deklaruar pasuritë që disponon.

ILDKPKI-së iu kërkua interpretim ligjor në lidhje me këtë konstatim.

Me shkresën, nr. ***, datë 30.05.2018, ILDKPKI-ja ka argumentuar se: *“Bashkëjetuesja e subjektit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për deklaram, për vitet 2014 dhe 2015, në përputhje me ligjin.”*

Në lidhje me këtë konstatim, pas kalimit të barrës së provës, në shpjegimet e datës 18.07.2018, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se: *“Rezulton e provuar se personi i lidhur, znj. A. O., në cilësinë e bashkëjetueses ka plotësuar detyrimin ligjor për dhënien e autorizimit për kontrollin e deklaratës së interesit/pasurive që nga viti 2012. Mosdeklarimi i znj. A.O., për vitet 2014 dhe 2015 nuk përbën shkelje të tillë ligjore që të ngarkojë me përgjegjësi administrative apo penale subjektin e rivlerësimit. Ky fakt që është konfirmuar nga ILDKPKI-ja, si autoritet përgjegjës, i cili nuk e ka evidentuar si shkelje gjatë këtyre viteve”.*

Arsyetimi ligjor

Lidhur me faktin që ILDKPKI-ja në raportin e saj nuk e ka evidentuar si shkelje, nuk do të thotë që subjekti ka përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht deklaratat e interesave pasurore. ILDKPKI-ja pasi është vënë në dijeni nga Komisioni është shprehur duke e cilësuar “shkelje” në kuptim të ligjit. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin ligjor, në zbatim të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, të deklarojnë të dhënat e detyrueshme për deklaram, pjesë përbërëse e këtij procesi deklarimi, me përshkrimet e kërkuara sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016. Kur pasuria e personave të lidhur është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas dhe i bashkëlidhet deklaratës së subjektit të rivlerësimit.

Komisioni, nisur nga fakti që personi i lidhur/bashkëjetuesja ka plotësuar vetëm faqen 8, të formularit “Autorizimin” dhe duke evidentuar faktin që disponon pasuri veçmas, por nuk ka deklaruar pasuritë në pronësi, ka konkluduar se:

→ **Deklarimi është i pamjaftueshëm sipas ligjit për deklaratat e interesave private periodike/vjetore për vitet 2014 - 2015.**

18.4 Komisioni, nga hetimi i kryer ka evidentuar faktin se në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” nuk është deklaruar burimi i krijimit të pasurive.

Arsyetimi ligjor

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shkelur detyrimin kushtetues dhe ligjor sepse, bazuar në pikat 2 dhe 3 të nenit D të Kushtetutës, ka detyrimin të dorëzojë një deklaratë të re dhe të detajuar, të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, si dhe, bazuar në pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

→ **Komisioni vlerëson se në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” deklarimi është i pamjaftueshëm në përputhje me ligjin.**

19. Pasuritë e deklaruara në Deklaratën - Vetting:

1. Apartament, sip. 59.7 m², vlera 12.218 lekë, në Berat (me pjesë takuese në ¼ pjesë subjekti);
2. Pasuri në fshatin Kutalli, Bashkia Ura Vajgurore, Berat. Fituar me ligjin nr. 7501, “Për tokën”, datë 19.07.1991, i ndryshuar, (në bashkëpronësi, me pjesë takuese 1/5 pjesë subjekti), si vijon:
Pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, me indeks harte, ***;
Pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, me indeks harte, ***; dhe
Pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, me indeks harte, ***.
3. Apartament, sip. 118 m², Tiranë, vlera 7.758.900 lekë. (e zotëron bashkëjetuesja 100%);
4. Garazh, sip. 20 m², Tiranë, vlera 14.500 euro (e zotëron bashkëjetuesja 100%);
5. Apartament, sip. 98.3 m², Golem, vlera 67.500 euro, paguar vlera 50.000 euro, detyrimi 17.500 euro (e zotëron bashkëjetuesja 100%);
6. Automjet tip, “Toyota RAV4”, vlera 1.400.000 lekë (e zotëron bashkëjetuesja me ½ pjesë);
7. Llogari në “BKT”, në vlerën 29.390 lekë;
8. Llogari, “Bank of America”, vlera 1.669 USD;
9. Llogari, “CHASE Bank”, vlera 1.767 USD;
10. Llogari, “American Invest Bank”, vlera 1.001 euro;
11. Aksione shoqëria “****” sh.p.k., me vlerë 100.000 lekë, bashkëjetuesja 100%.

Komisioni, verifikoi dhe hetoi pasuritë:

19.1 Apartament, me sip. 59.7 m², me vlerë 12.218 lekë, i ndodhur në Kutalli, Berat, i blerë në vitin 1995, në bashkëpronësi me familjarë të tij, pjesa takuese e subjektit ¼, fituar nga privatizimi i banesave shtetërore.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit

ZVRPP-ja Berat⁶, me shkresën nr. *** prot., datë 27.01.2018, nuk konfirmon pronësinë e kësaj pasurie dhe informon se: *“Nuk është bërë dixhitalizimi i të dhënave të pasurisë, zona urbane, është në proces të regjistrimit fillestar. Gjithashtu, ZVRPP-ja Berat informon se hipoteka për periudhat 1991 - 1997 është djegur dhe regjistrat hipotekorë që administrojnë kjo zyrë (për pasuritë e paluajtshme, të cilat janë të regjistruara në këta regjistra hipotekorë), nuk kanë indekse dhe se kërkimet tona për të dhëna pasurie janë manuale”.*

→ **Komisioni, nga hetimi i kryer ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.**

19.2 Pasuritë⁷ me adresë në fshatin Kutalli, Bashkia Ura Vajgurore, rrethi Berat; fituar për shkak të ligjit nr. 7501 “Për tokën”, datë 19.07.1991, i ndryshuar (në bashkëpronësi me familjarë të tij, me pjesë takuese 1/5), si vijon:

- Pasuria, nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk ***, me indeks harte ***;
- Pasuria, nr. ***, vol. ***, fq. ***, me indeks harte ***; dhe
- Pasuria, nr. ***, vol. ***, fq. ***, me indeks harte ***.

Burimi i krijimit sipas Deklaratës-Vetting: Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këto pasuri janë fituar me anë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

ZVRPP-ja Berat⁸, me shkresën nr. *** prot., datë 27.01.2018, ka konfirmuar se:

- Rezulton në pronësi të z. N.A., pasuria nr. ***, vol. ***, fq. *** e llojit “Arë”, me sipërfaqe 1299 m², zk. ***, fshati Kutalli, Njësia Administrative Kutalli, Bashkia Ura Vajgurore, sipas AMTP-së ***, datë 07.06.1995;
- Rezulton në pronësi të z. N.A., pasuria nr. ***, vol. ***, fq. *** e llojit “Ullishte”, me sipërfaqe 2050 m², zk. ***, fshati Kutalli, Njësia Administrative Kutalli, Bashkia Ura Vajgurore, përfituar sipas AMTP-së ***, datë 07.06.1995;

⁶ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 29.12.2017, drejtuar ZVRPP-së, me të cilën kërkohet informacion për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur.

⁷ Për këtë aset subjekti ka paraqitur vërtetim sipas kërkesës, nr. ***, datë 24.10.2016, nga ZVRPP-ja Berat, ku vërtetohet se z. N.A., ka të regjistruar pasuritë me nr. **10/10, 40/3, 66/20** e llojit Ullishte dhe Arë në zk *** Berat.

⁸ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 29.12.2017, drejtuar ZVRPP-së me të cilën kërkohet informacion për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur.

- Rezulton në pronësi të z. N.A., pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, e llojit “Arë”, me sipërfaqe 2000 m², zk ***, fshati Kutalli, Njësia Administrative Kutalli, Bashkia Ura Vajgurore, përfutur sipas AMTP-së ***, datë 07.06.1995.

→ **Komisioni, nga hetimi i kryer, ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.**

Pasuritë e deklaruara nga personi i lidhur/bashkëjetuesja në Deklaratën-Vetting:

19.3 Apartament, me sipërfaqe totale 118 m², me vlerë 83.200 USD (i zotëruar nga bashkëjetuesja 100 %) ndodhur në Tiranë, me adresë: Rr. “****”, i regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë.

19.4 Garazh, me sipërfaqe totale 20 m², me vlerë 9.000 USD (me pjesë zotëruese 100 % nga bashkëjetuesja) me adresë: Rr. “****”, i regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë.

Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në:

- Verifikimin e saktësisë së deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit.
- Burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

ZVRPP-ja Tiranë ka konfirmuar pasuritë e regjistruara në emër të znj. A.O. Komisioni vëren se, në Deklaratën-Vetting nuk është deklaruar burimi i ligjshëm të krijimit të pasurisë.

Nga Komisioni u hetua origjina e pronës dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar në dosje u konstatua se bashkëjetuesja ka përfutur pronësinë e pasurive të sipërcituara nëpërmjet kontratës së shkëmbimit, datë 18.11.2016⁹, nënshkruar ndërmjet palëve, znj. A.O. dhe motrës së saj, znj. A.O., duke shkëmbyer pasuritë në pronësi të tyre me njëra - tjetrën.

Bashkëjetuesja e subjektit përpara shkëmbimit kishte në pronësi apartamentin me sip. 66.60 m² dhe vlerë 7.758.900 lekë dhe garazhin me vlerë 14.500 euro, të ndodhura në adresën: Rr. “****”.

Komisioni nga hetimi i kryer, vëren se Znj. A.O., me cilësinë e porositeses, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. * rep., nr. *** kol., datë 01.03.2007, me shoqërinë “****” sh.p.k., kishte porositur tri pasuri:**

- Apartament, me sipërfaqe 74.2 m², me çmim blerjeje 1.200 euro/m², me vlerë fillestare 89.040 euro;
- Zyrë, me sipërfaqe 30 m², me vlerë 84.000 euro;
- Garazh, me vlerë 19.000 euro.

⁹ Sipas kontratës së shkëmbimit, znj. A.O., shkëmben pasuritë në pronësi të saj me adresë: Rr. “****”:

- Apartament, me sipërfaqe 66.60 m²;
- Garazh me nr. ****.

Pala tjetër në kontratën e shkëmbimit, znj. A.O., shkëmben pasuritë e saj në adresën: Rr. “****”:

- Apartament, me sipërfaqe 118m²;
- Garazh, me sipërfaqe 20 m².

Vlera totale për 3 asetet: **192.040 euro**.

Më datë 26.09.2008, bashkëjetuesja e subjektit ka shlyer shumën prej 131.500 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes shtesë me nr. *** rep., nr. *** kol., të nënshkruar nga palët. Për sa i takon ambientit të porositur “zyrë”, palët kanë revokuar pjesërisht kontratën e sipërmarrjes së vitit 2007. Mes palëve është rënë dakord që vlera totale e dy ambienteve të jetë *101.500 euro dhe shoqëria sipërmarrëse do t'i rikthejë porositëses shumën e mbetur prej 30.000 euro*.

Për shkak se shoqëria sipërmarrëse nuk kishte përmbushur në kohë dhe në cilësi porosinë sipas kontratës së sipërmarrjes (më datë 10.06.2013), ndërmjet shoqërisë ndërtuese dhe znj. O., nënshkruhet një akt rakordimi, ku palët janë dakordësuar që çmimi përfundimtar i shitjes së apartamentit të jetë në vlerën 7.758.900 lekë dhe garazhi në vlerën 14.500 euro. Pala sipërmarrëse ka deklaruar se është likuiduar për vlerën e plotë të apartamentit dhe garazhit.

Në datën 10.10.2013, palët kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes për apartamentin me sipërfaqe 66.60 m², i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, regjistruar në ZVRPP Tiranë, në emër të znj. A. O., më datë 24.02.2014.

Sikurse është konfirmuar nga shoqëria “****” sh.p.k., me shkresën nr. *** prot., datë 14.06.2018, ka deklaruar se: “Zj. A.O. ka paguar shumën prej 131.500 euro, në favor të shoqërisë së ndërtimit”. Ky fakt është konfirmuar dhe nga bashkëjetuesja e subjektit me përgjigjet e pyetësorit të datës 22.06.2018¹⁰. Diferenca e çmimit i është kthyer *cash* në dorë, në fund të shtatorit - fillim i tetorit 2008, znj. A.O. (bashkëjetuese e subjektit të rivlerësimit), nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas vërtetimit nr. ***, datë 28.05.2018, të lëshuar nga përfaqësuesi i kësaj shoqërie. Nga subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit asnjë provë ku të dokumentohet pagesa e kryer për blerjen e kësaj pasurie, si dhe për shumën e kthyer prej 30.000 euro nga shoqëria ndërtuese.

➤ **Komisioni, mbështetur në dokumentacionin ligjor, ka hetuar për të verifikuar nëse bashkëjetuesja e z. Bledar Abdullahi në vitet 2007 - 2008 ka pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e kryer prej 131.500 eurosh, sipas kontratës së sipërmarrjes shtesë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.09.2008, të nënshkruar nga palët.**

Duke analizuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit për blerjen e kësaj pasurie, vërehen deklaramë kontradiktore lidhur me kontributin e tij financiar, si në shpjegimet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ, ashtu dhe në shpjegimet e dhëna pas kalimit të barrës së provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës.

Komisioni, nëpërmjet komunikimit elektronik, më datë 22.03.2018, i ka kërkuar informacion z. Bledar Abdullahi, mbi “burimin e të ardhurave për pasuritë e regjistruara në emër të bashkëjetueses, si dhe i është kërkuar të sjellë evidenca ligjore në lidhje me punësimin e saj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe dokumentacionin mbështetës”.

¹⁰ Në dosjen e subjektit ndodhen përgjigjet e plota të pyetësorit të datës 22.06.2018.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e ardhura me shkresën nr. *** prot., datë 30.03.2018, ka shpjeguar, ndër të tjera, se: “Personi i lidhur A.O., si pronare e pasurive të referuara në “Deklaratën e Pasurisë së Personit të Lidhur”, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 27.01.2017, deklaroi se: në kushtet kur ky deklaram i saj në deklaratën e cituar më sipër, në kuadër të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përkuar njëkohësisht dhe si deklaram i saj fillestar pranë ILDKPKI-së, pasi nuk ka qenë subjekt më parë, - dhe se ndërkohë nuk ka pasur mundësi të japë sqarime eventuale, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen/verifikimin, çmon të sqarojë se në drejtim të burimit të krijimit të pasurive të saj, kanë shërbyer si të ardhurat e saj personale, ashtu dhe të ardhurat e përfituara nga marrëdhënie juridike të posaçme (të cilat kanë lindur dhe janë shuar në kohë para këtij deklarimi dhe për të cilat de facto dhe de jure ajo nuk ka qenë subjekt deklarimi), si më poshtë:

1. Të ardhura personale:

- a) Të ardhura nga punësimi pranë *** (***), në vitin 1999, në vlerën 1,350 (një mijë e treqind e pesëdhjetë)USD, referuar dokumentit që është depozituar pranë jush;
- b) Të ardhura nga paga si juriste pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, në vitet 1999-2000, në vlerën 94,237 (nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë) lekë, referuar dokumentit që është depozituar pranë jush;
- c) Kursime të saj të para viteve 2000, së bashku me interesat e përfituara prej tyre në vlerën 757,107(shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatë)lekë, referuar dokumentit mandat shlyerjeje depozitash (bashkëlidhur), lëshuar më datë 01.08.2000, nga “Banka e Kursimeve”, “Agjencia Bankare 1”;
- ç) Të ardhura nga punësimi jashtë shtetit me kohë të plotë për vitet 2002-2003, në vlerën 30,467 (tridhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) USD, referuar dokumentit që është depozituar pranë jush (vërtetimi i sigurimeve shoqërore, datë 23.10.2016), si dhe dokumentit që po depozitohet, konkretisht vërtetimi lëshuar, më datë 05.09.2003, nga punëdhënësi *** (***);
- d) Të ardhura nga paga dhe shpërblimet nga punëdhënësi, Ministria e Drejtësisë + shuma e paguar nga Sigurimet Shoqërore gjatë periudhës së punësimit pranë këtij institucioni (në vitet 2006 - 2011) në vlerën 3,047,836 (tre milion e dyzet e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, referuar dokumentacionit që është depozituar pranë jush;
- dh) Të ardhura nga paga si pedagoge me kohë të pjesshme, pranë “***” në Tiranë, në vlerën 17,100 (shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind) lekë, referuar dokumentit që është depozituar pranë jush;

- e) Të ardhura nga punësimi jashtë shtetit me kohë të pjesshme në vlerën 43,375 (dyzet e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) USD, referuar dokumentit të depozituar (vërtetimi i sigurimeve shoqërore, datë 23.10.2016);
- ë) Të ardhura nga qiraja në vlerën 3,600 (tre mijë e gjashtëqind) euro, referuar kontratës së qirasë, datë 17.05.2010, bashkëlidhur kontrata si dhe mandatet bankare që po ridepozitohen dhe që vërtetojnë zërin pagesë e tatimit të mbajtur në burim;
- f) Të ardhura nga kontrata e shërbimit, nr. ***, lidhur me ReSPA (financim i BE), në vlerën 3,000 (tre mijë)euro, referuar dokumentit që është depozituar pranë jush;
- g) Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit si notere publike në Bashkinë Tiranë prej muajit nëntor 2011 e në vijim në vlerën 13,206,720 (trembëdhjetë milion e dyqind e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë, referuar dokumentacionit që është depozituar pranë jush;
- gj) Të ardhurat e përfituara nga interesat e depozitave/kursimeve në sistemin bankar në emër të znj. A. O. Lidhur me depozitat/kursimet dhe burimin e krijimit të tyre, referoju për këtë përgjigjes së pyetjes 10 të këtij pyetësori shtesë.

2. Të ardhura të përfituara nga marrëdhënie juridike të posaçme:

- a) **Hua në vlerën 38,500** (tridhjetë e tetë mijë e pesëqind)USD, dhënë nga motra e saj znj. A.O., referuar deklaratës noteriale (certifikuar me apostile) të lëshuar nga kjo e fundit, më datë 29.01.2015, pranë noterit publik të shtetit të New York-ut (bashkëlidhur). Lidhur me këtë marrëdhënie huaje, znj. A.O., vlerëson të sqaroj se veç sa më sipër faktohet dhe nga transfertat ndërkombëtare bankare nga llogaria bankare e shtetases A.O. në llogarinë bankare të A.O., respektivisht më datë 07.03.2007, shuma 12,000(dymbëdhjetë mijë)USD; më datë 11.05.2007, shuma 14,000 (katërbëdhjetë mijë) USD, si dhe më datë 01.10.2007, shuma 12,600 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind) USD. Lidhur me burimet financiare të huadhënësës, znj. A.O., nga ana e saj i është vënë në dispozicion: statement i të ardhurave lëshuar në SHBA, dokumentacioni mbi të ardhurat e përfituara dhe tatimet e paguara ndër vite, vërtetimi i punëdhënësit, nga përmbajtja e të cilave rezulton se të ardhurat e shtetases A.O. në vitet 2006 - 2007 (që përkon me kohën e dhënies së huas) kanë qenë respektivisht, në vlerat 63,749 (gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë)USD dhe 27,241(njëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e dyzet e një)USD.
- b) Kontributi financiar i z. Bledar Abdullahi në cilësinë e prindit të fëmijës R.B.A. në vlerën 1,000,000 (një milion)lekë. Lidhur me burimin financiar të këtij kontributi nga ana e z. Bledar Abdullahi, është vënë në dispozicion praktika e kontratës së kredisë konsumatore me “Raiffeisen Bank” sh.a., datë 30.03.2007, praktikë të cilin po e depozitoj;
- c) Kontributi dhe ndihma financiare e vazhdueshme nga prindërit, referuar deklaratës noteriale (certifikuar me apostile) të lëshuar më datë 29.01.2018, pranë noterit publik të shtetit të New York-

ut (bashkëlidhur). Lidhur me burimet financiare të prindërve të saj, znj. A.O., informon se kanë qenë të ardhurat e përfituara nga pagat ndër vite, pensionet, interesat nga depozitat të pas vitit 1990 e në vijim, si dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme (apartament, dyqan kioskë), pasuri këto të përfituara dhe nga ligji nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", ku dhe ka qenë bashkëpronare, referuar këtij ligji si dhe të ardhurat e përfituara me vendim gjykate. Lidhur me sa më sipër, vë në dispozicion dokumentacionin që aktualisht disponoj, sikundër janë: - vërtetim depozite, viti 1998, "Banka e Kursimeve", - librezë kursimi në emër të znj. L.O. dhe/ose z. Rr.O., - vërtetim nga sigurimet shoqërore, - kontratë shitje pasurie të luajtshme/të paluajtshme.

ç) Kontributi financiar i vëllait z. S.O. për blerjen e automjetit (automjet ky cili është në bashkëpronësi). Lidhur me burimet financiare të bashkëpronarit z. S.O. nga ana e znj. A.O., deklarohet se i është vënë në dispozicion vërtetimi i të ardhurave.

d) Kontributi financiar dhe ndihma e vazhdueshme e z. Bledar Abdullai (si prind i fëmijëve dhe bashkëjetues) si dhe i prindërve të tij N. A. dhe A. A. Lidhur me burimet financiare të tyre sqarohet se të ardhurat e tyre kanë qenë të ligjshme (sikundër janë pagat e tyre ndër vite, e cila referuar dokumentacionit rezulton të jetë në total: 14,706,932 lekë + 3,258,478 lekë + 1,303,871 lekë + 3,002,903 lekë + 1,230,388 lekë + 46,119 lekë + 2,952,348 lekë = 26,501,039 lekë (njëzet e gjashtë milion e pesëqind e një mijë e tridhjetë e nëntë) lekë, dhe se ndërkohë nuk kanë realizuar gjithë jetën asnjë blerje pasurie të paluajtshme.

Znj. A.O., deklaron se ky informacion më i detajuar mbi faktet si më sipër, bëhet prezent në këtë moment (përpos arsyes së parashtruar apo dhe pyetjes së cituar më lart), edhe për faktin se pjesë e këtij dokumentacioni zyrtar që fakton marrëdhëniet si më sipër është siguruar nga riverifikimi dhe kërkimi i mëvonshëm, dhe që disponoheshin nga të afërmit e saj, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (akte këto për të cilat theksohet se rezulton të jenë lëshuar vite më parë nga miratimi i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë).

Ndërkaq, për sa i përket personit tjetër të lidhur, znj. A.O., nga ana e znj. A.O. deklarohet se aktualisht i është vënë në dispozicion: statement-i i të ardhurave lëshuar në SHBA, dokumentacioni mbi të ardhurat e përfituara dhe tatimet e paguara ndër vite, vërtetimi i punëdhënësit."

Lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e aseteve, me shkresën, nr. * prot., datë 30.03.2018, subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përsëritur ka argumentuar se:** "Personi i lidhur, znj. A.O., në drejtim të burimit të krijimit të pasurive të saj kanë shërbyer si të ardhurat e saj personale, ashtu dhe të ardhurat e përfituara nga marrëdhënie juridike të posaçme. Tek të ardhurat e përfituara nga marrëdhënie juridike të posaçme, subjekti ka listuar dhe kontributin financiar dhe ndihmën e vazhdueshme të vetën (si prind fëmijëve dhe bashkëjetues).

Në datën 30.06.2018, pranë Komisionit, z. Bledar Abdullahi, ka paraqitur një “Deklaratë”, ku ndër të tjera ka deklaruar shprehimisht se: *“Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, në kushtet kur hetimi që po kryhet në thelb ka të bëjë me identifikimin e integritetit tim si subjekt rivlerësimi, çmoj të vë në dukje se, z. Bledar Abdullahi është në raporte bashkëjetese me znj. A.O. dhe se raportet financiare i kanë të ndara; duke pretenduar se znj. A.O. disponon pasuri veçmas dhe nuk është në raporte pronësore me z. Bledar Abdullahi”*.

Gjithashtu, subjekti deklaroi shprehimisht se: *“Nga përmbajtja e akteve të depozituara pranë jush, është lehtësisht e verifikueshme se nuk ka asnjë element provues që z. Abdullahi, është i përfshirë në procesin e vënies së pasurisë/hyrjes në marrëdhënie kontraktore nga ana e zj. O. apo familjarë të saj”*.

Komisioni, gjatë procesit të hetimit administrativ ka marrë në konsideratë, ndër të tjera, edhe deklaratimet e përsëritura të z. Bledar Abdullahi të cilat janë reflektuar në analizën financiare dhe më datë 06.07.2018, i ka dërguar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.

Lidhur me burimin për blerjen e pasurive deklarohet ndihma financiare e prindërve të zj. A.O., në shumën prej 50.000 euro, të dhëna cash.

Në deklaratën e datës 29.01.2018, lëshuar nga znj. L.O., deklarohet se: *Ajo bashkë me babain e znj. A.O., e kanë mbështetur financiarisht A. për blerjen e pasurive në Rr. “***”*. Në deklaratë nuk jepen të dhëna se kur është dhënë ky kontribut dhe në çfarë shume konkrete. Në deklaratën e datës 13.07.2018, znj. L.O. shpjegon se: *Bashkë me bashkëshortin e saj kanë ndihmuar financiarisht me shuma të ndryshme monetare sipas nevojave të saj për blerjen e pasurive në vitet 2007 - 2008 dhe se kontributi në total ka qenë rreth vlerës prej 50.000 eurosh, kryesisht i dhënë cash dhe valutë.*

Komisioni verën se kjo deklaratë nuk është e shoqëruar me ndonjë dokumentacion mbështetës, për të provuar dhënien e këtyre parave dhe burimin e ligjshëm të tyre. Komisioni analizoi situatën financiare të prindërve bazuar në të ardhurat e tyre të fituara në vite, të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, nga ku rezultoi se në fund të vitit 2008, ata kanë mungesë të burimeve financiare në vlerën - 4,992,163 lekë (shih tabelën nr.4).

Nisur nga dokumentacioni i administruar në dosje, konfirmohet kontributi financiar në vlerën 1.000.000 lekë, me burim një kredi financiare të marrë nga subjekti në “Raiffeisen Bank” me destinacion për rritjen e fëmijës. Megjithatë, duke qenë se subjekti në shpjegimet e tij të datës 18.07.2018 ka kërkuar që të përfshihen të ardhurat e tij si kontribuues për mbulimin e shpenzimeve si prind, si dhe bashkëjetues, Komisioni ka konkluduar që kontributi financiar në vlerën 1.000.000 lekë dhe të ardhurat e krijuara nga pagat e z. Bledar Abdullahi të përfshihen në analizën financiare, deri në vitin 2008, si moment ky i krijimit të pasurive.

Referuar dokumentacionit të administruar në dosje, personi i lidhur/bashkëjetuesja, znj. A. O., nga muaji mars 2007 deri në shtator të vitit 2008 ka shlyer shumën prej 131.500 euro, për blerjen e 2 pasurive të ndodhura në rrugën “***”. (në analiza financiare për blerjen e dy pasurive të zotëruara 100 % prej saj pasqyrohet në tabelën nr. 2.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje (vërtetimet e pagave, dokumentacioni i ardhur nga SHBA) konstatohet se znj. A.O., nga viti 1999 e deri në vitin 2008, ka përfituar në total të ardhura nga pagat në vlerën prej **4.922.956** lekësh.

Në tabelën nr. 3 janë pasqyruar të ardhurat në vite të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, znj. A.O., shpenzimet e jetesës, si dhe shpenzimet për blerjen e pasurive (apartament + garazh, i ndodhur në rrugën “****”).

Komisioni ka konstatuar se, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit shpjegimet e subjektit kanë qenë tepër voluminoze, të paqarta e të pasakta në lidhje me kontributin e tij financiar për pasuritë e blera nga bashkëjetuesja.

Komisioni, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje ka kryer analizën financiare për të vlerësuar aftësitë paguese të znj. O. në shumën prej 131.500 eurosh, në favor të shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k., datë 26.09.2008.

Pasi i është kaluar barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, ka dërguar prapësimet e tij pranë Komisionit, ku ndër të tjera ngre pretendime lidhur me rezultatet e analizës financiare.

Trupi gjykues ka analizuar me objektivitet pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe këto janë reflektuar me ndryshimet përkatëse, në analizën financiare të prezantuar në seancën dëgjimore.

Referuar analizës financiare, sipas tabelës nr. 1 janë përlllogaritur të ardhurat e gjeneruara nga punësimi i subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, nga viti 1997 deri në vitin 2008, në total janë në shumën prej 6.532.140 lekë, dhe të ardhurat e gjeneruara nga punësimi i bashkëjetueses znj. A.O., në Shqipëri dhe në SHBA. Sipas dokumentacionit të administruar në dosje, nga sigurimet shoqërore në SHBA dhe nga vërtetimet e punësimit nga institucionet shtetërore ku ka punuar për periudhën nga viti 1999 - 2008, të ardhurat janë në shumën 4.922.956 lekë¹¹.

Theksohet se, në analizën financiare, personit të lidhur, znj. A.O., janë përfshirë të ardhurat e fituara nga punësimi në SHBA dhe gjatë periudhës 2006 - 2011, periudhë gjatë të cilës ka qenë e punësuar pa ndërprerje në Ministrinë e Drejtësisë¹².

¹¹ Konvertuar vlerat në monedhë të huaj bazuar te kursi mesatar i Bankës së Shqipërisë për vitet respektivë kur janë gjeneruar të ardhurat.

¹² Referoju dosjes së subjektit shkresës së Ministrisë së Drejtësisë, nr. ***, datë 04.05.2018.

Tabela nr. 1.

Vitet	Total të ardhurat në lekë, subjekti i rivlerësimit	Total të ardhurat në lekë, bashkëjetuesja	Total të ardhurat në lekë
1997	31.788	-	31.788
1998	164.860	-	164.860
1999	259.177	211.352	470.529
2000	425.132	68.767	493.899
2001	468.168	-	468.168
2002	506.514	1.514.269	2.020.783
2003	605.088	1.797.189	2.402.277
2004	762.071	-	762.071
2005	773.592	-	773.592
2006	819.260	272.119	1.091.379
2007	884.329	462.258	1.346.587
2008	832.161	597.002	1.429.163
Total	6.532.140	4.922.956	11.455.096

Për të vlerësuar aftësitë paguese të znj. A.O. për pagesën e kryer, në vlerën 131.500 euro, u përlogariten në total të ardhurat dhe shpenzimet e kryera për periudhën nga 1997 deri 2008, sipas tabelës nr. 2.

Tabela nr. 2.

Përshkrimi	Vitet 1999-2008 (në Lek)
Të ardhura nga pagat e subjektit	6.532.140
Të ardhura nga pagat e personit të lidhur, bashkëjetuesja ¹³	4.922.956
Kredi në vitin 2007, nga subjekti si kontribut për fëmijën	1.000.000
Blerë apartament banimi+garazh, në Tiranë, në vlerën 131.500 euro ¹⁴	- 16.198.499
Shpenzimet e jetesës dhe shlyerja e kredisë	- 5.066.650
Shpenzimet për udhëtime	- 815.797
Diferenca e pambuluar	- 9.625.850

¹³ Të ardhurat nga paga për personin e lidhur, bashkëjetuesen janë marrë nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, për institucionet ku ajo ka punuar ndër vite.

¹⁴ Konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2008.

→ **Komisioni bazuar në analizën financiare, nga analiza e provave dhe fakteve në tërësi, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën prej -9.625.850 lekë, për të justifikuar pagesën e kryer më datë 26.09.2008, në shumën prej deri 131.500 euro.**

Pas kalimit të barrës së provës:

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij ka argumentuar, ndër të tjera, se: *“Gjatë deklaramentit të burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive, personi i lidhur, znj. A.O., ka shpjeguar dhe faktuar nëpërmjet provave shkresore se blerja e pasurisë së llojit, apartament, objekt shqyrtimi, ka datuar përpara krijimit të marrëdhënies së posaçme me subjektin e rivlerësimit, si dhe burimet e krijimit të kësaj pasurie janë - të ardhurat personale nga punësimi - kursimet vetjake,- kontributet financiare nga anëtarët e familjes, sipas certifikatës familjare në kohën kur është blerë kjo pasuri. Për të vërtetuar sa më sipër, janë të administruara në dosjen e Komisionit të gjitha llogaritë dhe depozitat bankare të znj. A.O., dhe të familjareve të saj, të cilat në dukje janë analizuar nga Komisioni (pasi rezultojnë të jenë bërë shënime mbi to), por në raport nuk është pasqyruar asnjë analizë financiare apo përpunim i tyre, përkundrazi jashtë çdo logjike dhe standardi të mbajtur, Komisioni është shprehur se: "Personat e tjerë të lidhur kanë pasur depozita, por nuk ka rezultuar pakësim apo transferta nga këto depozita në favor të znj. A.O.".*

Referuar dosjes së krijuar pranë Komisionit, rezultojnë të administruara të dhëna bankare (të hyra dhe të dala), për znj. A.O. dhe familjarët e saj, për kohën që është krijuar pasuria objekt shqyrtimi. Këto të dhëna po të analizohen, si në tërësi ashtu edhe veç e veç, me të ardhurat personale nga puna e znj. A.O., provojnë dukshëm (i) ekzistencën e mjeteve financiare; (ii) ligjshmërinë e burimit të tyre, si edhe (iii) aftësinë paguese të znj. A.O. në kohën e krijimit të kësaj pasurie.”

Komisioni ka konkluduar se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë pasi janë të pabazuara dhe të pambështetura në prova. Referuar dokumentacionit të administruar në dosje, marrëdhënia e bashkëjetesës së tij me zj. A.O. ka filluar shumë vite përpara blerjes së pasurive.

Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me kontributin financiar të familjarëve të bashkëjetueses së tij, gjithashtu nuk u provua. Sipas tabelës vijuese nr. 4, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, rezulton se prindërit e bashkëjetueses nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të ndihmuar financiarisht znj. A.O. në blerjen e pasurive.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër, të ndryshëm nga ato të administruara në dosje, për të provuar pretendimet e tij.

19.5 Apartament, i ndodhur në Golem, me sipërfaqe 98.3 m², me vlerë 67.500 euro (zotëruar 100 % nga bashkëjetuesja e subjektit), referuar kontratës së sipërmarrjes, datë 15.10.2008. Është kryer pagesa prej 50.000 eurosh.

Në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie, në përputhje me ligjin.

Komisioni, nga hetimi i kryer, vëren se:

ALUIZNI ka konfirmuar se znj. A.O. është pajisur me leje legalizimi, datë 07.11.2017:

- Për sipërfaqen e parcelës ndërtimore takuese, sip. 25.80 m², dhe
- Sipërfaqen totale të ndërtimit për banim 90.53 m²,

si dhe është proceduar me dërgimin e dokumentacionit tekniko-ligjorë për regjistrimin e pasurisë së legalizuar në ZVRPP-në Kavajë.

ZVRPP-ja Kavajë ka konfirmuar se rezulton e regjistruar leja e legalizimit (datë 07.11.2017) në emër të znj. A.O., e llojit apartament, me sipërfaqe 90.53. m².

Bazuar në deklaratimet e subjektit, por dhe në deklaratën personale lëshuar nga znj. A.O., në analizën financiare të blerjes së apartamentit me vendndodhje në Golem, është përfshirë dhe huaja prej 38.500 USD, e konfirmuar dhe nëpërmjet transaksioneve bankare. Vlen të theksohet se pasuritë, apartament banimi + garazhi, me adresë: Rr. “****”, Tiranë dhe apartament, me sipërfaqe 98.3 m² në Golem (paguar vlera prej 50.000 eurosh) janë shlyer në vitin 2008, prandaj bazuar tek analiza financiare rezulton se:

Në vitin 2008, sikurse u argumentua më lart, nga shoqëria “****” sh.p.k., për shkak të mospërbushjes të detyrimeve në kohë dhe në cilësi, ka një ulje të çmimit të apartamentit në vlerën finale 7.758.900 lekë. Subjekti ka paguar vlerën prej 131.500 eurosh, dhe ka marrë mbrapsht diferencën. Kjo diferencë është përfshirë në llogaritje.

Subjekti, në lidhje me burimet e ligjshëm të përdorur dhe për blerjen e këtij aseti ka mbajtur të njëjtin qëndrim, si për asetet e trajtuar më sipër në pikën 3, duke deklaruar se: *“Në lidhje me pasuritë e blera nga znj. A.O. me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen/verifikimin, çmon të sqarojë se në drejtim të burimit të krijimit të pasurive të saj, kanë shërbyer si të ardhurat e saj personale ashtu dhe të ardhurat të përfituara nga marrëdhënie juridike të posaçme (të cilat kanë lindur dhe janë shuar në kohë para këtij deklarimi, dhe për të cilat de facto dhe de jure ajo nuk ka qenë subjekt deklarimi), si më poshtë: 1. Të ardhura personale.... 2. Të ardhura të përfituara nga marrëdhënie juridike të posaçme,*”.

Dhe për kontributin personal, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si për asetet e cituara në pikën 3, sa më sipër. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna, më datë 18.07.2018, ka kërkuar që të përfshihen të ardhurat e tij në analizën financiare, si kontribuues për mbulimin e shpenzimeve si prind fëmije dhe si bashkëjetues. Ndërkohë ai pretendoi se nuk është kontribuues në pasuritë e bashkëjetueses.

Në seancën dëgjimore, (marrë nga procesverbali i seancës dëgjimore, datë 26.07.2018), subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar shprehimisht se: *“ Ku është kontributi im, qoftë si prind, qoftë si bashkëjetues, sepse unë nuk rezultoj me asnjë pasuri. Pra, do të thotë që asaj shume duhet*

ti shtohet edhe kontributi im si prind i fëmijës në momentin e parë, deri pastaj si bashkëjetues. Prandaj ky fakt nuk është marr në konsideratë.”

Të ardhurat nga pagat të z. Bledar Abdullahi dhe kredia konsumatore janë përfshirë në analizën financiare në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3

Përshkrimi	Vitet 1999-2008 (në Lek)
Të ardhura nga pagat subjektit	6.532.140
Të ardhura nga pagat personi i lidhur, bashkëjetuesja	4.922.956
Kredi konsumatore e subjektit në vitin 2007	1.000.000
Hua nga motra në vlerën 38.500 USD	3.196.655
Blerë, ap. banimi + garazh në Tiranë, në vlerën 7.758.900 lekë + 14.500 euro	- 9.545.046
Apartament, me sip. 98.3 m ² , në Golem, me vlerë 50.000 euro ¹⁵	- 6.159.125
Shpenzimet e jetesës dhe shlyerja e kredisë ¹⁶	- 5.066.650
Shpenzimet për udhëtime	- 815.797
Diferenca e pambuluar	- 5.934.867

Nëpërmjet transaksioneve bankare, Komisioni ka konfirmuar huan në shumën 38.500 USD, e deklaruar nga znj. O. si burim lidhur me blerjen e pasurisë apartament me vendndodhje në Golem. Referuar analizës financiare, në përfundim të hetimit vërehet se:

→ **Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëjetuesja kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për të justifikuar blerjen e pasurive të paluajtshme në total, në shumën prej - 5.934.867 lekësh.**

Nga analiza e provave dhe fakteve në tërësi, konstatohet se ky subjekt ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2008. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm, si dhe nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie në përputhje me ligjin.

Në lidhje me pretendimet e subjektit për analizën financiare të realizuar nga Komisioni, subjekti në shpjegimet e datës 18.07.2018 ka pretenduar se analiza financiare nuk është e saktë

¹⁵ Konvertuar në lekë me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2008.

¹⁶ Për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës kemi marrë në konsideratë vlerën e shpenzimeve të jetesës për periudhën nga viti 2003 - 2008 sipas ILDKPKI-së, e cila është bazuar tek INSTAT, duke marrë në konsideratë dhe kontributin e bashkëjetueses për rritjen e fëmijës për periudhën 2005 - 2008, ndërsa për periudhën 2002 - 2003 bashkëjetuesja e z. Bledar Abdullahi ka jetuar në SHBA, dhe shpenzimet minimale për konsum personal janë llogaritur në vlerën 600 USD/muaj; në vit janë vlerësuar në vlerën 7.200 USD. Bazuar tek të ardhurat e gjeneruara prej saj në këtë periudhë. Për periudhën 1999 - 2001 për personin e lidhur, bashkëjetuesen janë llogaritur shpenzime minimale për konsum në vlerën 5.000 lekë/në muaj.

sepse nuk janë marrë në konsideratë nga komisioni kontributi financiar i personave të lidhur të tij dhe të familjarëve të bashkëjetueses¹⁷.

Komisioni, në lidhje me pretendimet e subjektit ka argumentuar se:

- 1. Referuar pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nuk janë marrë në konsideratë llogaritë e depozitave që bashkëjetuesja ka pasur para se të blinte pasuritë e saj, Komisioni ka identifikuar të gjitha gjendjet e llogarive bankare të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, znj. O., para blerjes së aseteve. Nga verifikimi rezulton se, më datë 07.02 2006, ajo ka tërhequr nga banka shumë prej 34,000 USD-sh, si dhe nuk dihet destinacioni i përdorimit të tyre. Pas kësaj date janë identifikuar depozitime në monedhën euro të cilat mund të kenë ardhur nga konvertimi i depozitës në dollarë tërhequr më parë. Në kohën kur bashkëjetuesja ka hyrë në marrëdhënie kontraktore, kjo shumë nuk ishte gjendje në dokumentacionin bankar të ofruar nga banka, të administruar në dosje. Kur subjekti është pyetur për burimin e ligjshëm për krijimin e pasurisë, nuk është deklaruar se janë përdorur shumat në depozita. Për analogji, subjekti ka deklaruar për asetin e blerë në Golem, se është përdorur si burim, shuma prej 38.500 USD-sh, huaja e dhënë nga motra e bashkëjetueses. Kjo shumë është konfirmuar dhe nga dokumentacioni i siguruar nga bankat e nivelit të dytë, nga ku rezulton se e motra e bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit ka kryer tre transferta në emër të znj. A.O. gjatë periudhës mars-tetor të vitit 2007 dhe kjo hua është vlerësuar në përllogaritje.*
- 2. Një tjetër pretendim që ngre subjekti për shpenzimet e jetesës së bashkëjetueses, lidhet me mbulimin e tyre nga familjarët e saj, komisioni argumenton se, për shpenzimet e jetesës janë përllogaritur shpenzime minimale për konsum si gjatë kohës së qëndrimit në shtetin amerikan po ashtu dhe në shtetin shqiptar. Minimumi jetik për shpenzimet në SHBA., janë llogaritur nga të dhënat të ofruara nga vëzhguesi ndërkombëtar që ka ndjekur këtë çështje. Ky është një standard i përdorur nga Komisioni në të gjitha analizat financiare. Gjithashtu, dhe për shpenzimet e udhëtimeve në SHBA, janë marrë në konsideratë dhe nuk janë të pasqyruara në analizën financiare si shpenzime, ato udhëtime që rezultojnë të provuara me dokumentacion.*
- 3. Në lidhje me pretendimin se në analizën financiare nuk është marrë në konsideratë kontributi i dhënë bashkëjetueses nga prindërit e saj, komisioni ka kryer një analizë financiare, referuar dokumentacionit në dosje.*

Prindërit e personit të lidhur, bashkëjetueses A.O., janë trajtuar me pension pleqërie dhe sipas shkresës nr. *** prot., dhe nr. *** prot., të datës 28.03.2018, të lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Tiranës, të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit informohemi se:

- të ardhurat nga pensioni i pleqërisë për babain e zj. O., nga data 01.10.1991 - 31.03.2018, janë në shumën 4.349.927 lekë;

¹⁷ Duke qenë që materiali i depozituar nga subjekti është shumë voluminoz, për më shumë referoju shpjegimeve argumentuese të subjektit në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ të datës 18.07.2018, si dhe dokumenteve shoqëruese.

- të ardhurat nga pensioni i pleqërisë për nënën e zj. O., nga data 21.11.1994 - 31.03.2018, janë në shumën 2.536.748 lekë.

Gjithashtu nëpërmjet një vërtetimi të sjellë nga subjekti i rivlerësimit nga dega e Bankës së Kursimit, Lezhë, datë 18.02.1998, rezultoi se znj. L.O. ka pasur pranë kësaj banke një depozitë prej 1.825.937 lekësh, me afat tremujor, e përfshirë në analizën financiare.

Të ardhurat e siguruara nga prindërit e znj. A.O. sipas deklaramentit janë: - të ardhurat e siguruara nga pensionet, - nga ushtrimi i aktivitetit si avokat i z. Rr.O. (ato të ardhura të provuara me dokumentacion), - të ardhurat e siguruara nga shitja e pasurive të paluajtshme, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit. Këto të ardhura janë të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 4

Vitet	Të ardhurat e prindërve të bashkëjetueses në lekë	Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	Shpenzime për blerjen e pasurive të paluajtshme	Shpenzimet e prindërve të A.O., në lekë	Të ardhurat neto të prindërve të A.O., në lekë
1991	41,037			120,000	- 78,963
1992	164,148			120,000	44,148
1993	164,148			120,000	44,148
1994	173,208			120,000	53,208
1995	272,866			120,000	152,866
1996	272,866		2,650,000 ¹⁸	120,000	- 2,497,134
1997	272,866			120,000	152,866
1998	272,866	460,000 ¹⁹		120,000	612,866
1999	272,866			120,000	152,866
2000	379,866			120,000	259,866
2001	621,166			120,000	501,166
2002	681,998			120,000	561,998
2003	272,866		5,869,260 ²⁰	120,000	- 5,716,394
2004	272,866			120,000	152,866
2005	272,866			120,000	152,866
2006	272,866			120,000	152,866
2007	272,866			120,000	152,866
2008	272,866			120,000	152,866
Totali deri në vitin 2008					- 4,992,163

¹⁸ Në vitin 1996 është blerë nga prindërit e bashkëjetueses një shtëpi me adresë: "Rr. ***", me vlerë 2.650.000 lekë.

¹⁹ Në vitin 1998 është shitur një kioskë në lagjen "****" në Lezhë, me vlerë 460.000 lekë.

²⁰ Në vitin 2003 është blerë nga prindërit e bashkëjetueses truall + ndërtesë, me vlerë 54.000 USD ose e konvertuar në lekë me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003, në vlerën 5.869.260 lekë.

2009	272,866	4,407,497 ²¹		120,000	4,560,363
2010	272,866			120,000	152,866
2011	272,866		1,527,250 ²²	120,000	- 1,374,384
2012	272,866			120,000	152,866
2013	272,866			120,000	152,866
2014	272,866			120,000	152,866
2015	272,866			120,000	152,866
2016	272,866			120,000	152,866
Totali deri në vitin 2016					4,103,175
Total	7,410,025	4,867,497	10,046,510	3,120,000	- 888,988

Nga hetimi administrativ, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, ka rezultuar se prindërit e bashkëjetueses së subjektit kanë blerë dhe shitur pasuri të paluajtshme në vite, konkretisht: në vitin 1996 kanë blerë apartament në vlerën 2.650.000 lekë, i shitur në vitin 2009 në vlerën 4.407.497 lekë; kanë blerë një pasuri (truall + ndërtesë) në vitin 2003 në vlerën 54.000 USD; kanë shitur dyqan (kioskë në vlerën 460.000 lekë), si dhe apartament (zyrë) të blerë në vitin 2011, në vlerën prej 1.527.250 lekësh.

Ata kanë pasur në total të ardhura në vlerën **5.227.097 lekë**, deri në fund të vitin 2008. Të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme deri në këtë vit kanë qenë në vlerën **460.000 lekë**, ndërsa investimet në pasuri të paluajtshme deri në fund të vitit 2008 kanë qenë në vlerën **8.519.260 lekë** dhe shpenzimet për jetesë kanë qenë në vlerën **2.160.000 lekë**. Komisionit i rezultoi se në fund të vitit 2008, ata kanë mungesë të burimeve financiare për të justifikuar investimet në pasuri të paluajtshme në vlerën - 4,992,163 lekë.

Komisioni ka konkluduar se:

- **Pretendimet e subjektit lidhur me kontributin e prindërve të bashkëjetueses në blerjet e pasurive nuk u provuan, referuar analizës financiare.**

Pasuri të luajtshme:

19.6 Automjet²³, tip “Toyota RAV4”, me vit prodhimi 2007, me numër shasie *, blerë sipas kontratës së shitblerjes së automjetit, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.02.2009, në shumën 1.400.000 lekë. (bashkëjetuesja zotëron ½ pjesë).**

Referuar Deklaratës-Vetting, nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie.

²¹ Në vitin 2009 është shitur apartamentit me adresë: Rr. “***”, me sip.79.4 m², në Tiranë me vlerë 4.407.497 lekë, i blerë në vitin 1996.

²² Në vitin 2011 është blerë nga prindërit e bashkëjetueses pasuria ,apartament, sip.20.5 m², me vlerë 1.527.250 lekë.

²³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës, kontratën e shitblerjes, nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 12.02.2009, në vlerën 1.400.000 lekë.

ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur se: *“Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e DPSHTRR”-së.*

Nga subjekti na është vënë në dispozicion një shkresë nr. *** prot., datë 05.04.2018, e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror, nëpërmjet të cilës informohemi se z. S.O. ka pasur të ardhura nga paga bruto në subjektin “****” sh.p.k., nga muaji prill i vitit 2008 deri në muajin qershor të vitit 2011 kanë qenë në vlerën 200.000 lekë/muaj.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor²⁴ me shkresën, nr. ***, datë 09.01.2018, ka konfirmuar se personi i lidhur, bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit, ka në bashkëpronësi me vëllain e saj, mjetin tip “Toyota RAV4”.

Në pyetësorin dërguar me *e-mail-in* e datës 14.05.2018, në përgjigjet e tij ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 21.05.2018, rezulton se z. S.O., ka lëshuar një deklaratë personale sipas të cilës ka deklaruar se: *“Z. S.O. është pronar i automjetit tip “Toyota Rav 4”, dhe se ka paguar plotësisht çmimin e pagesës së automjetit të mësipërm, për regjistrimin e tij si dhe në vazhdim për kostot e mirëmbajtjes për periudhën që kam jetuar në Shqipëri. Ky automjet është vënë në punë dhe është përdorur nga unë për nevoja personale dhe vazhdoj ta përdor kur shkoj për vizitë në Shqipëri, si pasojë vazhdoj të paguaj për të gjitha shpenzimet që kanë lidhje me këtë automjet..... Burimi i të ardhurave të përdorura për këtë blerje dhe për mirëmbajtjen e automjetit tip “Toyota Rav4”, kanë qenë nga punësimi im”.*

Komisioni hetoi lidhur me aftësitë pagueuse të vëllait të bashkëjetueses së z. Bledar Abdullahi, lidhur me pagesat e kryera për krijimin e kësaj pasurie.

Komisioni, nga informacioni i kërkuar, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me shkresën, nr. *** prot., të datës 05.04.2018, ka konfirmuar se: *Z. S.O., ka pasur të ardhurat nga paga bruto, nga punësimi në firmën “****” sh.p.k., për periudhën nga prill i vitit 2008 deri në qershor të vitit 2011, në shumën 200.000 lekë/muaj.*

Komisioni, nisur nga dokumentacioni i administruar në dosje dhe analiza financiare, ka konstatuar se vëllai i bashkëjetueses ka pasur mundësi financiar për të kryer pagesën e plotë dhe të gjitha shpenzimet e deklaruara për këtë automjet.

Në përfundim të hetimit vërehet se:

→ Për këtë pasuri përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje.

²⁴ Në dosje ndodhet shkresa e Komisionit, nr. *** prot., datë 29.12.2017, drejtuar DPSHTRR-së, ku kërkohet informacion mbi çdo automjet të regjistruar në emër të subjektit apo personit të lidhur me të.

19.7 Llogari²⁵ kursimi dhe rrjedhëse, në “Bankën Kombëtare Tregtare”, në shumën **29.390** (njëzetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë. Referuar Deklaratës -Vetting, nuk është deklaruar burimi i krijimit të këtyre likuiditeteve.

Nga hetimi i kryer nga ana e Komisionit, ka rezultuar se, “Banka Kombëtare Tregtare”²⁶ me shkresën me nr. *** prot., datë 18.01.2018, ka konfirmuar se, bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit disponon llogari me gjendje 0 lekë, në datën 27.01.2017.

19.8 Llogari kursimi²⁷ dhe

19.9 Llogari rrjedhëse, në total në shumën **3,451 USD** (tremijë e katërqind e pesëdhjetë e një), Referuar Deklaratës - Vetting, nuk është deklaruar burimi i krijimit të këtyre likuiditeteve.

19.10. Llogari²⁸ kursimi në euro, **1,001** (njëmijë e një) euro.

Referuar Deklaratës -Vetting, nuk është deklaruar burimi i krijimit të këtyre likuiditeteve.

Nga hetimi i kryer nga ana e Komisionit, “American Invest Bank”²⁹, me shkresën nr. *** prot., 17.01.2018, ka konfirmuar se bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit disponon llogari kursimi, në shumën 1.001 euro.

Komisioni, nga analiza e dokumentacionit të administruar vëren se:

→ **Në lidhje me gjendjet e llogarive bankare nuk janë rezultuar pasaktësi, deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.**

19.11 Kapital³⁰, në vlerën 100 lekë në shoqërinë “****” sh.p.k. (regjistruar më datë 11.04.2013, dhe aplikuar për pezullim, më datë 16.04.2013, dhe aplikuar për çregjistrim më datë 18.04.2013) – shoqëri në likuidim e sipër, me të ardhura 0 lekë.

Nga hetimi i kryer nga ana e Komisionit, Qendra Kombëtare e Biznesit³¹, me shkresën me nr. *** prot., datë 22.01.2018, konfirmon se znj. A. O., e datëlindjes 23.02.1976, figuron ortake e vetme

²⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga “BKT”, me gjendje, më datë 24.01.2017, me vlerë 22.951 lekë.

²⁶ Në dosjen e subjektit ndodhet shkresa e Komisionit me nr. *** prot., datë 29.12.2017, drejtuar 27 bankave dhe institucione bankare, ku i kërkohet informacion dhe të dhëna bankare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

²⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie, “Bank of America”, datë 17.01.2017, vlera 1.669 USD.

- Nxjerrje llogarie, “CHASE Bank”, datë 12.10.2016, vlera 1.767 USD.

²⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie, “Amerikan Invest Bank”, datë 24.1.2017, vlera 1.001 euro.

²⁹ Shih në dosjen e subjektit shkresën e Komisionit me nr. *** prot., datë 29.12.2017, drejtuar 27 bankave dhe institucione bankare, ku i kërkohet informacion dhe të dhëna bankare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të

³⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë regjistrimi, QKR-së, me NIPT ***+ vërtetim aplikimi + ekstrakt QKB-së.

- Certifikatë regjistrimi, QKR-së, me NIPT ***.

³¹ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 29.12.2017, drejtuar QKB-së, ku i kërkohet informacion dhe dokumentacion mbi marrëdhënie të mundshme biznesi, veprimtarie tregtare apo veprimtari profesionale, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

në shoqërinë “****” sh.p.k., e pajisur me NUIS ***. Aktualisht ky subjekt rezulton të jetë me status “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Komisioni ka kërkuar informacion bankar për llogaritë bankare³² të shoqërisë “****” sh.p.k., dhe ka rezultuar se nuk konfirmohen të dhëna bankare.

Komisioni, nga analiza e dokumentacionit të administruar vëren se:

→ **Në lidhje me llogarinë bankare nuk kanë rezultuar pasaktësi dhe deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.**

20. Pas kalimit të barrës së provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, nëpërmjet komunikimit elektronik, pas kalimit të barrës së provës në shpjegimet e datës 18.07.2018, ka dërguar prapësimet e tij pranë trupit gjykues, ku ndër të tjera ka pretenduar se “bashkëjetesa ka nisur në vitin 2012”.

Subjekti në pretendimet e tij të datës 06.07.2018, por dhe në përgjigjet e pyetësorit të datës 22.03.2018 ka argumentuar shprehimisht se: “*Znj. A.O., për arsye personale dhe familjare, që nga viti 2006 e në vijim ka qëndruar në Shqipëri sipas rrethanave dhe kushteve të saj familjare me/tek prindërit e saj z. Rr.O. dhe znj. L.O. (gjatë kohës që prindërit e saj kanë qenë prezent në Shqipëri, eventualisht të dy së bashku ose secili veç e veç) për shkak dhe moshës së tyre të thyer e gjendjes shëndetësore të rënduar, si dhe në shtetin e New York-ut”.*

Në shpjegimet e tij ka deklaruar se, bashkëjetuesja e tij ka qëndruar në SHBA për një kohë të gjatë, për arsye personale/familjare, kjo distancë e ka bërë të pamundur bashkëjetesën e tyre në kuptim të parashikimit të nenit 163 të Kodit të Familjes.

20.1 Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, në nenin 163, ka parashikuar kuptimin e bashkëjetesës ku përcaktohet se: “*Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie”.*

20.2 Komisioni lidhur me këtë pretendim, analizoi dokumentacionin e administruar në dosje, ku vëren se:

- Ministria e Drejtësisë³³, me shkresën nr. *** prot., datë 04.05.2018, nga dokumentacioni i administruar në dosje, ka konfirmuar se bashkëjetuesja e subjektit, znj. A.O., ka punuar pa shkëputje nga puna, me kohë të plotë pranë këtij institucioni nga viti 2006-2011.
- Në deklaratimet vjetore të interesave private dhe pasurore dhe në Deklaratën-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar atësinë e 3 fëmijëve, përkatësisht të datëlindjeve 2005,

³² Shih në dosjen e subjektit shkresën e Komisionit me nr. *** prot., datë 08.06.2018, drejtuar 17 bankave, ku i kërkohej informacion dhe të dhëna bankare shoqërinë “****” sh.p.k.

³³ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 12.04.2018, drejtuar MD-së, me të cilën është kërkuar informacion për periudhën e punësimit dhe të shkëputjes nga puna të zj. A.O. gjatë punësimit të saj pranë këtij institucioni.

2009 dhe 2013. Fakt ky që tregon se bashkëjetesa ka nisur që në vitin 2004, ajo ka qenë e qëndrueshme dhe e shtrirë në kohë.

- Referuar deklaramenteve në vite, se, z. Bledar Abdullahi në deklaratat vjetore nga 2004 - 2016, ka deklaruar adresat e gjendjes civile dhe adresat e tjera të vendbanimit, si më poshtë:

Viti	Adresat e deklaruara nga subjekti
2003	Pll. “***”, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë.
2004	Njësia Admin. Nr. ***, Rr. “***”, Pll. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë (në 2004, kjo adresë ka qenë pasuri në pronësi të babait të bashkëjetuesit).
2005	Njësia Admin. Nr. ***, Rr. “***”, Pll. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë.
2006	Njësia Admin. Nr. ***, Rr. “***”, Pll. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë.
2007	Adresa e Gjendjes Civile: Njësia Admin. Nr. ***, Rr. Tiranë. Vendqëndrim tjetër: Rr. “***”, Pallati pranë liceut, Ap. *** (në 2007, kjo pasuri ka qenë në pronësi të motrës së bashkëjetueses).
2008 - 2011	Adresa e Gjendjes Civile: Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë.
2012 - 2015	Adresa e Gjendjes Civile: Njësia administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë.
2016	Adresa e Gjendjes Civile: Njësia Bashkiake Nr. ***, Rr. “***”, Shk. ***, kati ***, Ap. ***, Tiranë; pasuri në pronësi të motrës së bashkëjetueses Vendqëndrim tjetër: Rr. “***”, Ndërtesa ***, Hyrja ***, Ap. ***, Tiranë (në këtë vit kjo pasuri ka kaluar në pronësi të bashkëjetueses)
2017	Adresa e Gjendjes Civile: Njësia Bashkiake Nr. ***, Rr. “***”, Shk. ***, kati ***, Ap. ***, Tiranë (pasuri në pronësi të motrës së bashkëjetueses);

Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, u konstatua se këto banesa janë në pronësi të prindërve të bashkëjetueses, të bashkëjetueses, apo familjarëve të saj, si:

- banesa në rrugën “***”, ish-banesë në pronësi të prindërve të bashkëjetueses;
- banesa në rrugën “***”, në pronësi të motrës së bashkëjetueses;
- banesa në rrugën “***”, blerë nga motra e bashkëjetueses, aktualisht në pronësi të bashkëjetueses;
- banesa në rrugën “***” blerë nga bashkëjetuesja, aktualisht në pronësi të motrës.

- ZVRPP Tiranë ka konfirmuar se nga kontrolli në regjistrin elektronik, z. Abdullahi nuk rezulton të ketë ndonjë banesë në Tiranë të regjistruar në pronësi të tij.

- Nga hetimi i kryer ka rezultuar se OSSHE-ja dhe UKT-ja kanë konfirmuar faktin se z. Abdullahi nuk është kontraktor në shërbimet e ofruara prej tyre.
 - Ministria e Drejtësisë ka konfirmuar se bashkëjetuesja e subjektit ka punuar pa shkëputje, me kohë të plotë, pranë këtij institucioni, nga viti 2006 - 2011.
 - Nga vetëdeklarimet e subjektit, prindërit e z. Abdullahi kanë ardhur me banim në Tiranë, në vitin 2012, pas daljes në pension.
 - Nga të dhënat e ofruara nga sistemi TIMS, konfirmohet fakti se bashkëjetuesja ka një numër të konsiderueshëm udhëtimesh në SHBA, te familjarë të saj (nga 2005 deri në vitin 2017 numërohen në total rreth 20 udhëtime, mesatarisht 2 në vit).
 - Në seancë dëgjimore, z. Abdullahi deklaroi mospasjen e një marrëveshjeje (kontratë) formale për vlefshmërinë e së cilës kërkohet respektimi i formës së aktit noterial përkatës. Me anë të kësaj marrëveshjeje palët mund të rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore, sikurse është kontributi material që secili prej tyre mund të japë në interes të familjes dhe bashkëjetesës, apo dhe detyrime të tjera që do të përmbushen gjatë bashkëjetesës apo pas përfundimit të saj.
- Pretendimi i tij lidhur me regjimin pasuror veçmas, nuk u provua.

20.3 Arsyetimi ligjor

Komisioni, bazuar në tërësinë e fakteve sa më sipër, sipas dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe në përkufizimin ligjor të “bashkëjetesës”, referuar Kodit të Familjes, vëren se subjekti i rivlerësimit ka pasur një marrëdhënie të vazhdueshme me bashkëjetuesen që nga viti 2004 e në vijim, fryt i së cilës janë fëmijët e tij. Z. Abdullahi, duke mos disponuar banesë në Tiranë, ka jetuar në një banesë me bashkëjetuesen dhe jo me prindërit e tij, pasi ata kanë jetuar në Kutalli, Berat, dhe pas daljes në pension në vitin 2012, kanë ardhur me banim në Tiranë. Udhëtimet e bashkëjetueses te familjarët e saj në SHBA nuk e përjashtojnë ekzistencën e marrëdhënies së bashkëjetesës. Këto udhëtime nuk provojnë pretendimet e subjektit sepse bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit dhe pas vitit 2012 (ku, siç pretendohet ka nisur bashkëjetesa) ka vijuar të udhëtojë në SHBA, duke kaluar kohë me familjarët e saj.

20.4 Komisioni ka vlerësuar se provat e administruara në dosje kanë nivelin e provueshmërisë dhe pretendimi sa më sipër mbi “bashkëjetesën” e subjektit të rivlerësimit nuk u provuan me dokumentacion mbështetës, pretendim i cili ka për qëllim shmangien e përgjegjësisë ligjore, ku, ndër të tjera, ka cenuar rëndë figurën dhe integritetin e gjyqtarit.

21. Në lidhje me apartamentin e poseduar në vite, pa kundërshpërblim, subjekti u ngarkua me barrën e provës, për të provuar burimin e ligjshëm për këtë pasuri, të ndodhur në rrugën “***”, ish-pronë e motrës së bashkëjetueses.

21.1 Gjatë procesit të hetimit administrativ, subjekti ka sjellë dokumentacion të paplotë, me pretendimin se koha kur është blerë ky aset është më shumë se 10 vjet, dhe personi tjetër i lidhur (motra e bashkëjetueses) është në pamundësi për ta siguruar të plotë këtë dokumentacion, lidhur me të ardhurat e fituara në vite nga punësimi i saj në SHBA.

21.2 Bazuar në pikën 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive të paraqesë dokumentacionin e plotë, që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive. Për këtë shkak, pretendimet e subjektit për sa më sipër, u morën në konsideratë nga trupi gjykues, duke e përjashtuar nga barra e provës për pasuritë në pronësi të personit tjetër të lidhur.

21.3 Komisioni arrin në përfundimin se,

→ **Provat e administruara në dosje nuk janë të mjaftueshme për të kryer një analizë të plotë financiare lidhur me burimet e ligjshme në blerjen e këtij aseti.**

22. Në lidhje me “pyetësorin-tip”

Nëpërmjet komunikimit elektronik, në “pyetësorin-tip” të dërguar nga Komisioni subjekti, ndër të tjera, është pyetur nëse ka përdorur pasuri të regjistruara në emrin e dikujt tjetër (si automjete, shtëpi, anije, apartamente, shtëpi pushimi etj.) në 7 vjetët e fundit.

Subjekti është përgjigjur: “Jo”.

22.1 Nga hetimi i kryer nga Komisioni, ZVRPP Tiranë ka konfirmuar se subjekti nuk disponon pasuri të regjistruara në emrin e tij në Tiranë. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se ka banuar në apartamente në pronësi të bashkëjetueses së tij apo të familjarëve të saj.

22.2 Nga verifikimi i deklarimeve të paraqitura në vite nga subjekti i rivlerësimit, konfirmohet fakti se z. Abdullahi ka përdorur pasuri në emër të personave të tjerë, në përputhje me nenin 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni.

22.3 Komisioni, gjatë procesit të rivlerësimit ka konstatuar:

→ **Deklarime të rreme në përgjigjet e pyetësorit.**

23. Rekomandimi i relatorit për vlerësimin e pasurisë

Sa më sipër, pavarësisht nga raporti i hollësishëm i dërguar nga ILDKPKI-ja për të bërë një vlerësim të pasurisë së subjektit të rivlerësimit sa më objektiv dhe të paanshëm, është kryer hetim i thelluar dhe i gjithanshëm administrativ nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

23.1 Nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ ka rezultuar se ka pasaktësi dhe pamjaftueshmëri të deklarimeve; ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë në emër të bashkëjetueses, si person i lidhur me subjektin e rivlerësimit; ka mosdeklarim për investimet e personave të lidhur, konkretisht të prindërve të tij, si dhe për pasuritë e deklaruara në Deklaratën-Vetting; subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 84/2016.

23.2 Nga analiza financiare, duke përlogaritur të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të ardhurat e personit të lidhur, bashkëjetueses, ka rezultuar se nuk kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për blerjen e pasurive të paluajtshme. Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti, nga analiza financiare e Komisionit rezulton se personat e tjerë të lidhur, prindërit e bashkëjetueses, nuk kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për të ndihmuar dhe për të qenë kontribuues në pasuritë e blera nga bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit.

23.3 Sa më sipër, nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehen se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit janë të pamjaftueshme dhe të pasakta në përputhje me ligjin. Bazuar në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë.

24. REZULTATET PËRFUNDIMTARE PËR KRITERIN E PASURISË

24.1 Në përfundim të hetimit administrativ lidhur me vlerësimin e pasurisë, sipas neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, pasi janë marrë në konsideratë edhe shpjegimet, dokumentet e paraqitura nga subjekti në ushtrim të së drejtës së barrës së provës, sipas parashtrimeve të datës 18.07.2018, si dhe parashtrimet e tij në seancë dëgjimore, Komisioni ka konstatuar se:

24.2 Deklarimi është i pasaktë, për shkak se personat e lidhur, të përmendur në certifikatën familjare, nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor për deklaram në “Deklaratën e Pasurisë-Vetting”, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Këta persona duhet të deklaronin saktësisht dhe plotësisht pasuritë.

24.3 Në “Deklaratën e Pasurisë -Vetting” deklarimi është i pamjaftueshëm, për shkak se burimi i ligjshëm i krijimit nuk është deklaruar, në kundërshtim me detyrimin kushtetues dhe ligjor. Sipas paragrafit në pikën 2 dhe 3 të nenit D të Kushtetutës, subjekti ka detyrimin të dorëzojë një deklaratë të re dhe të detajuar, për të shpjeguar në mënyrë bindëse origjinën e ligjshme të asetëve dhe të të ardhurave dhe, në bazë të paragrafit 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

24.4 Deklarim i pamjaftueshëm lidhur me mosdeklarimin e likuiditeteve në shumën totale prej 2.900.000 lekësh (për investimet në emër të prindërve) bazuar në nenin 33, pika 5/a, të ligjit nr. 84/2016.

24.5 Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2008, në bazë të nenit 33, pika 5/b, të ligjit nr. 84/2016.

24.6 Deklarimi është i pamjaftueshëm në deklaratat e interesave private, periodike/vjetore, për vitet 2014, 2015, për shkak se bashkëjetuesja nuk ka deklaruar pasuritë, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, të ndryshuar.

B. KONTROLLI I FIGURËS

25.Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar *mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi.*

25.1 Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

25.2 Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

25. Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi vlerësimin e aftësive profesionale

Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit është kryer nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, e cila ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

Raporti është bazuar në:

- Formularin e vetëdeklarimit, 3 (tre) dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe te të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 (pesë) dosjet penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Të dhënat nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Gjithashtu, raporti i hartuar nga Inspektorati i KLD-se është bazuar duke iu referuar kritereve të vlerësimit, si:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;

d) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Bledar Abdullahi ka marrë titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës, në vitin 2000 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon edhe aktualisht.

26.1 Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për gjyqtarin Bledar Abdullahi janë paraqitur gjithsej 15 ankesa në Inspektoratin e KLD-së.

KLD ka informuar mbi 1 ankesë të vitit 2014, për zvarritje dhe mosrespektim formal ligji, ku gjyqtarit i është tërhequr “vëmendja me shkrim”, për shkak se është konstatuar gjykimi i një çështjeje civile, për një kohëzgjatje prej 2 vitesh e 13 ditësh, tej afatit standard të parashikuar për këtë lloj çështjeje_civile.

26.2 Inspektorati i KLD-së, nga shqyrtimi i 5 dokumenteve të përzgjedhura me short, sipas një sistemi rastësor, ka konstatuar kryesisht probleme që kanë të bëjnë me shkelje të afateve në gjykimin e çështjeve, si më poshtë vijon:

Në çështjen civile nr. 1 është evidentuar vonesa në arsyetimin e vendimeve, pas 1 muaji e 9 ditësh nga shpallja, tej afatit procedural civil të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, ka zgjatur gjithsej 1 vit, 2 muaj e 10 ditë, kjo kohëzgjatje është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, germa “e”, e Aneksit 1 të sistemit të vlerësimit³⁴. Subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Këto problematika janë evidentuar dhe në 3 çështjet e tjera të zgjedhura me short.

Në çështjen administrativo-penale nr. 5, me objekt “Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj të dyshuarit J.M., për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve në bashkëpunim”, përfunduar me vendimin në 02.07.2016.

- i. Në seancën gjyqësore nr. 1, të datës 02.07.2016, gjykata ka shpallur vendimin: *“Vleftësim të ligjshëm të arrestit në flagrancë për personin në hetim, J.M., dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në shtëpi’, të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, duke urdhëruar lirimin e personit nën hetim”*.
- ii. Mbi ankimin e prokurorit, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur *ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për sa i përket masës së sigurimit personal, duke*

³⁴ Sistemi i vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.04.2010, të KLD-së “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” së bashku me Aneksin I, “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

caktuar atë të “arrestit në burg”, me arsyetimin se masa e sigurimit “arrest në burg” garanton procedimin deri në zbardhjen e plotë të hetimeve.

- iii. Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar për masën e sigurimit, janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, në sekretarinë e gjykatës, pas 25 ditëve nga shpallja, duke tejkaluar me 20 ditë afatin 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i K. Pr. Penale.
- iv. Gjykimi ka zgjatur gjithsej dy ditë. Brenda afatit 48 orë nga paraqitja e kërkesës në gjykatë, është caktuar 1 seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive, pasi është shqyrtuar dhe përfunduar gjykimi, duke shpallur edhe vendimin përfundimtar.

26.3 Pranë Komisionit janë paraqitur 9 denoncime nga publiku, të cilat u dërguan pranë KLD-së, për verifikim dhe nga ku, nga përgjigjet e KLD-së³⁵ nuk rezultoi se ka indice për të provuar pretendimet e denoncuesve.

Komisioni, në vlerësimin e aftësive profesionale u bazua në konstatimet e raportit të KLD-së, në shpjegimet e dhëna nga subjekti, denoncimet e ardhura, si dhe në analizën e bërë, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

27. Rekomandimi i relatorit për vlerësimin e aftësive profesionale

Për sa më sipër, me cilësinë e relatores së çështjes, mbështetur në raportin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi në masë të pranueshme në punë, që kanë të bëjnë me shkelje të afateve në gjykimin e çështjeve, zvarritje dhe mosrespektim formal të ligjit. Për shkak të gjykimit të çështjes, tej afatit standard të parashikuar për këto lloje çështjesh civile, gjyqtarit Bledar Abdullahi i është tërhequr “vëmendja me shkrim” nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Meqenëse në ligj është parashikuar “efiçent dhe efektiv në masë të pranueshme”, bazuar në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit propozoj: “I aftë”.

IV. SEANCA DËGJIMORE

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më datë 19.06.2018, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, në seancë dëgjimore në datën 26.07.2018, ora 10:00, në Pallatin e Kongreseve, në Tiranë, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit.

³⁵ Referoju shkresës së Komisionit me nr. *** prot., datë 25.04.2018, si dhe përgjigjeve të KLD-së.

Z. Abdullahi është njoftuar nëpërmjet komunikimit elektronik, me *e-mail*, në datën 23.07.2018. Subjekti ka paraqitur shpjegime dhe një kërkesë për thirrje dëshmitar që, me vendim të trupit gjykues, u refuzua.

Në seancën dëgjimore të datës 26.07.2018, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, duke deklaruar përfaqësimin e tij me avokatin Artan Hajdari. Avokati i subjektit të rivlerësimit deklaroi se nuk ishte dakord me rezultatet e hetimit, duke e trajtuar “bashkëjetesën” në planin e përgjithshëm si koncept. Ndërsa z. Abdullahi me shpjegimet e tij u ndal më në detaje të na shpjegonte bashkëjetesën e tij, duke pretenduar se kjo bashkëjetesë i kish fillesat nga 2012-ta e në vijim, duke deklaruar se fëmijët e tij (përkatesisht të datëlindjeve 2005, 2009, 2013) nuk ishin fryt i bashkëjetesës, por thjesht nga marrëdhënie seksuale.

Subjekti i rivlerësimit kërkoi rikonfirmimin në detyrë.

V. KONKLuzioni PëRFUNDIMtar

Pas analizimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në Deklaratën e Pasurisë-Vetting, të raporteve të ardhura nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLD-ja, shpjegimeve dhe provave/dokumenteve të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit, deklarimeve të subjektit me anë të postës elektronike, si dhe ato në seancë dëgjimore dhe pas analizimit të provave shkresore të administruara në bazë të neneve 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në përputhje me nenin 61, pika 3, pasi:

- ✓ deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
- ✓ ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ✓ deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë;

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, me detyrë gjyqtar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall sot në Tiranë, më datë 30.07.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj